



AVOKAT EGZON DOLI

Adresa: rr. "Tirana" p.nr – përballë Gjykatës dhe Prokurorisë Themelore Gjakovë

Tel: +38345279460, email: avegzondoli@outlook.com

PËR:

- Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK)/Komisionit për Ankesa dhe Arbitrazh;

CC:

- Komisioni i Garave pranë FKB-së;

NGA:

- Klubi Basketbollit (KB) "Vllaznimi" – Gjakovë, të cilin e përfaqëson Ideal Bakija, e të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Egzon Doli;

Në kuptim të dispozitave të Propozicionit të Garave për Kategorinë Seniore për edicionin 2025/2026, parashtrajmë këtë:

ANKESË

NDAJ:

- Publikimit/Njoftimit zyrtar të rrëdhitjes përfundimtare tabelare për edicionin e rregullt basketbollistik senior në vitin 2025/2026, të publikuar nga FBK me dt. 10.04.2026 në web-faqen zyrtare dhe rrjetin social "Facebook";

PËR SHKAK TË:

- Zbatimit të gabuar të dispozitave materiale-juridike;

Siç tashmë është publikuar tabela e rrëdhitjes së klubeve basketbollistike të Superligës së Kosovës për Senior në edicionin 2025/2026, KB "Vllaznimi" është klasifikuar në vendin e 8-të të rrëdhitjes tabelare, e rrjedhimisht nga rrëdhitja e tillë rezulton se i njëjti ka rënë nga kategoria superiore në Ligën e Parë të Basketbollit të Kosovës.

Kësisoj, në kuptim të nenit 47 të Propozicionit të Garave (P.G) për Kategorinë Seniore për edicionin 2025/2026, e cila dispozitë është e vetme që rregullon çështjen e ndarjes së pikëve dhe përcaktimin e plasmanit përfundimtar të klubeve basketbollistike brenda edicionit kampional 2025/2026, **rrjedhë se në situatën kur më shumë se dy klube (pra së paku tre klube) kanë grumbulluar numër të njëjtë të pikëve, renditja do të përcaktohet vetëm dhe ekskluzivisht mbi bazën e kosh-diferencës të pikëve të shënuara në ndeshjet ndërmjet tyre.** Pra, nga neni 47.1.4 i P.G rrjedhë se kriteri i parë dhe mbizotërues mbi të gjitha kriteret tjera, në rastin kur kemi barazim të pikëve ndërmjet së paku tre klubeve, është kosh-diferenca e pikëve të shënuara ndërmjet tyre.

Në rastin konkret, duke qenë kosh-diferenca e pikëve të shënuara ndërmjet tre klubeve basketbollistike që në fundin e tabelës kanë pikë të njëjta pra KB "Vllaznimi", KB "Sigal Prishtina" dhe KB "Rahoveci 029", **është pozitive në anën e KB "Vllaznimi" në ndeshjet e zhvilluara ndërmjet këtyre tre klubeve**, atëherë rrjedhë se në rastin konkret rradhitja tabelare e KB "Vllaznimi" nuk është bërë në pajtim me kriteret e detyrueshme të renditjes tabelare që janë përcaktuar me nenin 47.1.4 të P.G, andaj edhe si e tillë duhet të ndryshohet.

Nisur nga **interpretimi sistematik i normave juridike**, i cili edhe mbi bazën e praktikës së organeve gjyqësore dhe administrative por edhe të shkencës juridike, është i aplikueshëm si formë e interpretimit, rrjedhë se norma nga neni 47.1.4 është e renditur para normës nga neni 47.1.5 të P.G, ashtu që neni 47.1.5 i P.G nuk mund të gjejë zbatim në rrethanat e rastit konkret, dhe atë për dy arsye kyçe:

- I. Neni 47.1.5 i P.G i referohet situatës kur së paku tre klube kanë pikë të barabarta (që në rastin konkret ekziston) si dhe kur fitoret reciproke "kokë më kokë" ndërmjet tyre janë të barabarta, pra fitore të barabarta me njëra tjetrën ndërmjet KB "Vllaznimi" vs. KB "Rahoveci 029", ndërmjet KB "Sigal Prishtina" vs. KB "Rahoveci 029" dhe ndërmjet KB "Vllaznimi" vs. KB "Rahoveci 029" (**gjë që në rastin konkret nuk ekziston**) e që i bie se nuk janë plotësuar të dy kriteret në mënyrë që neni 47.1.5 të vihet në zbatim.
- II. Neni 47.1.4 i P.G ka karakter shtjerrues që d.m.th, nëse në një situatë konkrete bëhet zgjidhje për sa i përket përcaktimit të renditjes tabelare mes së paku tre klubeve me pikë të barabarta, atëherë nuk mund të kalohet në kritere të tjera të renditjes tabelare, përkatësisht nuk mund të kalohet në aplikimin e kriterëve nga neni 47.1.5.

Për më tepër në nenin 47.1.4 ekskluzivisht përdoret formulimi ligjor si në vijim "*Nëse më shumë se dy ekipe kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve, renditja përcaktohet **vetëm** në bazë kosh-diferencës të pikëve të shënuara ndeshjet në mes tyre*", pra përdoret tog-fjalëshi "**VETËM**", që d.m.th **vetëm** mbi bazën e kosh-diferencës përcaktohet renditja tabelare në momentin kur ka barazi të pikëve mes së paku tre klubeve (që në rastin konkret P.G e përdor shprehjen "nëse më shumë se dy ekipe" e praktikisht i bie së paku tre ekipe). Zbatimi dhe interpretimi i normave juridike në rastin kur ato në formulim janë të qarta dhe të zbatueshme përkitazi me rrethanat e rastit, nuk është çështje e diskrecionit të organit por është çështje e detyrimit ligjor dhe sigurisë juridike, sepse mbi bazën e rregullave të tilla janë nisur dhe vazhduar garat në edicionin kampional 2025/2026.

Tutje, për sa i përket neni 5 të P.G që përcakton rregullën se nëse një dispozitë e caktuar në P.G bie në kundërshtim me Rregullat Zyrtare të Basketbollit, atëherë këto të fundit do të mbizotërojnë, theksojmë se P.G për nga karakteri është akt nënligjor, përkatësisht i njëjti nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin, për çka në rastin konkret në kuptim të nenit 33 parag. 1 të Ligji Nr. 08/L-277 për Sport parashihet se "*Gara sportive **ndërkombëtare** në Republikën e Kosovës organizohet në përputhje me këtë ligj si dhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga federata ndërkombëtare e sportit përkatës*" gjë që në rastin konkret, edicioni kampional në basketboll për senior 2025/2026 nuk ka

karakter të garës sportive ndërkombëtare por është ekskluzivisht garë nacionale-vendore. Nga kjo rrjedhë se, renditja tabelare përfundimtare e edicionit të rregullt të garave të basketbollit për senior në edicionin 2025/2026 ekskluzivisht përcaktohet vetëm mbi bazën e kriterëve të P.G, ndërsa paqartësitë eventuale brendapërbrenda P.G apo ndërmjet dispozitave të P.G dhe Rregullave Zyrtare të Basketbollit, assesi nuk mund të interpretohen në dëm të një klubi dhe në dobi të një klubi tjetër.

Klubit të Basketbollit “Vllaznimi” sikurse edhe çdo klubi tjetër garues në edicionin e seniorëve për vitin 2025/2026 në fillim të edicionit i janë vënë në dispozicion rregullat e përcaktimit të plasmanit përfundimtar, ashtu që me të drejtë KB “Vllaznimi” ka ndërtuar pritje legjitime se plasmani përfundimtar në tabelë do të bëhet vetëm dhe ekskluzivisht mbi bazën e dispozitave të përcaktuara në aktin e titulluar “Propozicionit të Garave (P.G) për Kategorinë Seniore për edicionin 2025/2026”, pra jo në bazë të ndonjë akti tjetër apo interpretimi tjetër. Në rastin konkret çfarëdo interpretimi apo zbatimi i çfarëdo akti tjetër, është pa efekt juridik dhe assesi nuk mund të rrënoj pritjet legjitime të secilit klub të ndërtuara që në nisje të kampionatit. Në të kundërt parimi i sigurisë juridike dhe i garancisë për gara fer dhe të drejta do të shkelej rëndë.

Për sa i përket çështjes së normativës së FIBA, ky mekanizëm ndërkombëtar (FIBA) vendos kriterë përkitazi me lojën dhe rregullat teknike të ndeshjeve basketbollistike, ndërsa çështja e përcaktimit të kriterëve për klasifikim të rradhitjes tabelare të klubeve, është çështje që ekskluzivisht rregullohet nga FBK me anë të Propozicionit të Garave në edicionin përkatës. Pranë Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (CAS) tashmë me tre vendime gjyqësore është trajtuar situata e ngjajshme me atë çfarë gjendemi ne në rastin konkret përkatësisht në rastet CAS 2013/A/2426, CAS 2011/A/2426, CAS 2011/A/4745 është paraparë se çështja e klasifikimit të ekipeve në rradhitjen tabelare përcaktohet ekskluzivisht mbi bazën e rregullativës së brendshme të shteteve. Nëse eventualisht situatën e tillë FBK vijon t’a intepretoj në kontekst të rregullativës së FIBA-së, atëherë edhe tek çështja e numrit të lojtarëve të natyralizuar FBK e ka lejuar disa lojtar të natyralizuar të jenë pjesë e një ekipi përkundër se rregullorja e FIBA përcakton se duhet të jetë vetëm një lojtar i natyralizuar brenda një ekipi, që dmth se po aplikohen standarte të dyfishta për sa i përket zbatimit të normativës.

Siç tashmë është e ditur edhe për Ju, portali i njohur si “Asisti Online” i cili specifikisht merret ndeshjet basketbollistike në Kosovë me dt. 05.04.2026, pas konsultimeve me zyrtarët kompetent të FBK-së (siç e cek edhe në vet videon e publikuar), paraqiste intereptimin e situatës ndërmjet KB “Vllaznimi”, KB “Rahoveci 029” dhe KB “Sigal Prishtina” saktësisht mbi bazën e nenit 47.1.4 të P.G, duke vënë në pah kriterin e koshdallimit ndërmjet këtyre tre ekipeve të rradhitura në fundin e tabelës me pikë identike. Poashtu, KB “Vllaznimi” pas përfundimit të ndeshjes me KB “Sigal Prishtina” është konsultuar edhe me komisarin e garave pikërisht për të njejtën çështje pra është konsultuar me zt. Faton Kurshumliu, ku i njejtë ka dhënë interpretim identik me atë çfarë përmban neni 47.1.4 dhe atë çfarë e ka publikuar edhe portali “Asist Online” me dt. 05.04.2026. Nga kjo rrjedhë se të gjitha pritjet për sa i përket tabelës së klasifikimit kanë qenë të tilla çfarë edhe pretendohet me këtë ankesë.

Nga qasja e tillë e zyrtarëve të FBK-së (pa precizuar emra) të cilët vetëm disa orë para nisjes së ndeshjes KB “Vllaznimi” vs. KB “Peja”, duke e keqinterpretuar P.G dhe duke dhënë interpretime të cilat janë në kundërshtim me P.G, është shfaqur tendencë e hapur ndaj KB “Vllaznimi” përkatësisht me dashje jepen keqinterpretime të P.G, ashtu që nëse eventualisht kjo ankesë nuk aprovohet përkatësisht nuk vendosjet situata e ligjshmërisë, atëherë si Klub ne do të ndjekim rrugët ligjore përmes kallëzimit penal ndaj zyrtarëve përkatës të FBK-së për shkelje me dashje të dispozitave të P.G dhe krijimin e paqartësive juridike, për një situatë juridik të pastër si loti, duke shkaktuar kështu dëme të rënda materiale dhe jomateriale për KB “Vllaznimi”

Për shkaqet e lartëcekura, me respekt i propozojmë titullit të lartëpërmendur që të marr këtë:

V E N D I M


APROVOHET si e bazuar ankesa e KB “Vllaznimi” e parashtruar ndaj rradhitjes përfundimtare tabelare në edicionin e rregullt basketbollistik për senior në vitin 2025/2026 të publikuar nga FBK me dt. 10.04.2026 në web-faqen zyrtare, ashtu që **NDRYSHOHET** rradhitja përfundimtare tabelare dhe e njejta bëhet vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në nenin 47.1.4 të P.G, përkatësisht parashtruesi i ankesës KB “Vllaznimi” rradhitet në vendin e 7-të në tabelën përfundimtare të edicionit të rregullt basketbollistik për senior në vitin 2025/2026.

Gjakovë, dt. 10.04.2026



Përfaq. autorizuar

Egzon DOLI, avokat



Ideal Bakija – Drejtor



AVOKAT EGZON DOLI

Adresa: rr. "Tirana" p.nr – përballë Gjykatës dhe Prokurorisë Themelore Gjakovë

Tel: +38345279460, email: avegzondoli@outlook.com

Unë Ideal Bakija – Drejtor i KB "Vllaznimi" me seli në Gjakovë adresa rr. "Ismail Qemali" me nr. të regjistrimit 5110677-6 dhe nr. fiskal 601167530, me vullnetin tim të lirë dhe të pandikuar nga ndonjë e metë juridike, si dhuna, lajthimi apo mashtrimi, sot me dt. 10.04.2026 jap këtë:

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIM

Përmes të cilit e autorizoj avokat Egzon Doli me seli në Gjakovë, ashtu që i autorizuari ka të drejtë t'a përfaqësoj KB "Vllaznimi" në të gjitha procedurat gjyqësore, policore, administrative, prokuroriale apo të gjitha organeve në Republikën e Kosovës përkitazi me çështjen juridike ku paraqitet si palë. I autorizuari në emër dhe llogarinë e KB "Vllaznimi" mund të ndërmarr veprimet e mëposhtme procedurale:

- Të parashtrij, përpiloj dhe nënshkruaj, në emër dhe llogarinë time kërkesa, padi, deklarata, propozime, ankesa apo çfarëdo parashtrise ose pune juridike pranë të gjitha organeve kompetente në Republikën e Kosovës;
- Të përfaqësoj pranë të gjitha instancave gjyqësore, administrative, prokuroriale, policore apo të gjitha organeve të tjera në Republikën e Kosovës, me të drejtën e tërheqjes së çfarëdo dokumentacioni të nevojshëm pranë organeve gjyqësore, administrative apo organeve të tjera, ku unë paraqitem si palë;
- Të përfaqësoj në procedurën e ndërmjetësimit në rast nevoje, të zhvilloj negociata me trashëgimtarët e tjerë apo palët e treta pa kufizim, përkatësisht të lidhë marrëveshje jashtëgjyqësore si dhe të heq dorë nga procedura e tillë, e poashtu në emër dhe llogarinë time të nënshkruaj marrëveshje jashtëgjyqësore apo të gjitha punët juridike të nevojshme për zgjidhjen e çështjes për të cilën autorizohet;
- Të bëj pagesën e taksës gjyqësore apo të taksave tjera administrative në rast nevoje;
- Që në emër dhe llogarinë e klubit të ketë të drejtë të parashtrij të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme ndaj vendimeve gjyqësore apo administrative, si dhe të heq dorë nga parashtrimi i tyre.
- Të ndërmarrë të gjitha veprimet tjera pa kufizim në emër dhe llogari të klubit, e të cilat veprime nuk janë paraparë në pikat e mësipërme të këtij autorizimi.

Gjakovë, dt. 10/04/2026

AUTORIZIMDHËNËSI

KB "Vllaznimi" të cilin e përfaqësoj Ideal Bakija – Drejtor i klubit

